

IKD-ja dhe GLPS-ja: Qeveria në detyrë po vepron në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PDK-ja DHE ALEANCA RRISIN PRESIONIN PËR KONSTITUIMIN E KUVENDIT, AKUZAT NDAJ KURTIT PËR UZURPIM THELLOHEN

FAQE 4-5



PDK-ja dhe Aleanca kanë shtuar presionin politik për konstituimin e Kuvendit, duke dorëzuar kërkesë zyrtare për vazhdimin e seancës konstituive. Deputetët e PDK-së kanë zhvilluar një aksion simbolik

para Qeverisë dhe në Kuvend. Kjo parti ka kërkuar që procesi të vazhdojë pa u kushtëzuar me marrëveshjen për presidentin. Deputeti i PDK-së, Enver Hoxhaj, e ka akuzuar Albin Kurtin se po

qëndron në zyrën e kryeministrit pa legjitimitet, ndërsa Vlora Çitaku ka kërkuar që ai të kthehet në Kuvend për ta konstituuar institucionin dhe për ta formuar qeverinë

AKTUALE



GJERMANIA DHURON RRETH 3 MILIONË EURO PËR AVANCIMIN E KAPACITETEVE TË FSK-së F. 3

ZGJEDHJET E 7 QERSHORIT VLERËSOHEN TË LIRA DHE KONKURRUESE, POR KËRKOHET HETIM PËR VOTIMIN JASHTË VENDIT F. 3

ARRESTOHET NJË PERSON NË MERDAR NËN DYSHIMIN PËR SPIUNAZH F. 6

EKONOMI



KUSARI-LILA PRET NË TAKIM DELEGACIONIN E BANGLADESHIT, SYNOHET THELLIMI I BASHKËPUNIMIT EKONOMIK F. 8

KOMUNAT PLANIFIKOJNË PROTESTË NË MBROJTJE TË BUXHETEVE KOMUNALE F. 8

SPORT



SUPERLIGA E KOSOVËS NË FUTBOLL NIS SOT ME NDESHJEN NË DRENAS F. 11

RAMA: UKRAINA E KA GABIM PËR KOSOVËN, POR SHOIPËRIA DO TË VAZHDOJË TA MBËSHITESË F. 3



TITULLARËT SHTETËRORË, ME LEGJITIMITET TË KONTESTUAR F. 5



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Arabia Saudite, Pakistani dhe Turqia krijojnë strukturë të përbashkët politike dhe ushtarake

ANKARA, 13 GUSHT - Arabia Saudite, Pakistani dhe Turqia do të krijojnë një mekanizëm të përbashkët politik dhe ushtarak në kuadër të Marrëveshjes së Mbrojtjes së Përbashkët të Mekës, të nënshkruar më 7 gusht. Sipas Ministrisë së Mbrojtjes së Turqisë, marrëveshja synon ta thellojë bashkëpunimin mes

tri shteteve, përfshirë edhe sektorin e industrisë së mbrojtjes.

Struktura e re do t'i përfshijë ministrat e mbrojtjes, ministrat e jashtëm dhe shefat e ushtrive të Arabisë Saudite, Pakistanit dhe Turqisë. Në kuadër të paktit pritet të organizohen edhe stërvitje të përbashkëta ushtarake,

ndërsa bashkëpunimi mund të shtrihet edhe në prodhimin e përbashkët të pajisjeve të mbrojtjes dhe shkëmbimin e teknologjisë ushtarake. Ministria turke e Mbrojtjes ka bërë me dije se marrëveshja synon forcimin e koordinimit politik, diplomatik dhe ushtarak ndërmjet tri vendeve.



TRUMPI HAP 'THESIN' PËR SHTËPINË E BARDHË, MBI 900 MILIONË DOLLARË PËR RIKONSTRUKSIONE

WASHINGTON, 13 GUSHT - Administrata e presidentit amerikan Donald Trump pritet të shpenzojë më shumë se 900 milionë dollarë për një sërë projektesh ndërtimi dhe rikonstruksioni në kompleksin e Shtëpisë së Bardhë, ku pjesa më e madhe e financimit besohet se do të vijë nga fondet publike, raportojnë mediet amerikane.

Sipas "Washington Post", administrata ka siguruar paratë përmes transferimeve nga agjenci të ndryshme federale dhe kontributeve private, pa kërkuar një financim të drejtpërdrejtë nga Kongresi. Fondet janë transferuar në llogarinë e posaçme për riparimin dhe restaurimin e Rezidencës Ekzekutive, për projekte që Shtëpia e Bardhë i cilëson pjesë të modernizimit të kompleksit. Mes ndërhyrjeve të planifikuara

janë ndërtimi i një salle të madhe pritjesh në Krahun Lindor, rikualifikimi i sheshit Lafayette, ndërtimi i një heliporti, krijimi i një qendre të re për kontrollin e vizitorëve dhe punime të tjera infrastrukturore. Kostoja e përgjithshme e projekteve vlerësohet të arrijë të paktën 927 milionë dollarë.

Plani është përballur edhe me një pengesë ligjore. Një gjykatë federale apeli ka vendosur të premten se ndërtimi i sallës së re në Krahun Lindor kërkon miratimin e Kongresit. Në vendimin e tyre, gjyqtarët Patricia A. Millett dhe Bradley N. Garcia kanë theksuar se Kongresi ka kompetencën ekskluzive për ta autorizuar ndërtimin ose prishjen e strukturave në kompleksin e Shtëpisë së Bardhë.

Trumpi ka deklaruar se do ta apelojë vendimin. Ndërkohë,

Shtëpia e Bardhë nuk ka publikuar një shifër përfundimtare për të gjithë projektin dhe as nuk ka dhënë detaje të plota mbi burimet e financimit.

Zëdhënësi i Shtëpisë së Bardhë, Davis Ingle, i ka mbrojtur projektet, duke thënë se ato po realizohen në përputhje me qëllimet e përcaktuara nga Kongresi. Sipas tij, Trumpi po punon për t'i përmirësuar dhe modernizuar objektet e Shtëpisë së Bardhë, në mënyrë që ato të jenë në gjendje të mirë edhe për brezat e ardhshëm.

Sipas të dhënave të cituara nga "Washington Post", administrata Trump ka transferuar rreth 875 milionë dollarë në llogarinë e mirëmbajtjes së Rezidencës Ekzekutive që prej marrjes së detyrës. Kjo shumë është dukshëm më e lartë krahasuar me fondet e zakonshme, të cilat



në vitet e fundit kanë qenë rreth 2.5 milionë dollarë në vit. Raporti ngre gjithashtu pikëpyetje mbi transparencën e shpenzimeve, pasi kontratat po administrohen përmes

Rezidencës Ekzekutive, një strukturë që nuk u nënshtrohet të njëjtave kërkesa për transparencë dhe publikim të të dhënave si shumica e agjencive federale.

ZELENSKY: DISA RAJONE U RIKTHYEN NËN KONTROLLIN E KIEVIT



KIEV, 13 GUSHT - Ukraina ka rimarrë kontrollin e 745 kilometrave katrorë territor të pushtuar nga Rusia gjatë këtij viti, në një prej segmenteve të frontit në juglindje të vendit. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka deklaruar se operacioni po zhvillohet sipas planit dhe se forcat e Kievit kanë rikthyer nën kontroll 26 vendbanime. Sipas Zelenskyt, operacioni është zhvilluar përgjatë një segmenti prej rreth 60 kilometrash, në zonën ku takohen rajonet

Dnipropetrovsk, Donetsk dhe Zaporizhzhia. "Operacioni ynë ofensiv u zhvillua me saktësi, pikërisht sipas planit", ka shkruar presidenti ukrainas në rrjetin social "X", duke vlerësuar veçanërisht njësitë ajrore-desantuese dhe forcat e tjera të përfshira në operacion. Megjithatë, kontrolli mbi territorin e pretenduar nga Kiev mbetet i paqartë në disa zona. Sipas hartës së grupit ukrainas DeepState, një pjesë e konsiderueshme e territorit klasifikohet si "zonë gri",

ndërsa disa zona vijojnë të shënohen si nën kontrollin rus, shkruan "Reuters".

Kievi ka thënë se gjatë muajve të fundit ka shtuar presionin ndaj forcave ruse përmes kundërofensivave në segmente të ndryshme të frontit si dhe sulmeve ndaj infrastrukturës logjistike dhe energjetike. Rusia, nga ana tjetër, ka kërkuar që Ukraina të tërhiqet nga pjesa e mbetur e rajonit, duke e mbajtur të hapur përplasjen për kontrollin territorial.

Gjermania regjistron 12 500 të vdekur nga nxehtësia

Berlin, 13 gusht - Valët e të nxehtit në Gjermani gjatë këtij viti kanë shkaktuar rreth 12 500 të vdekur deri më tani, një shifër dukshëm më e lartë se në vitet e kaluara, ka njoftuar Instituti Robert Koch (RKI),

autoriteti gjerman i shëndetit publik. Në raportin e fundit javor, RKI-ja ka vënë në dukje se, krahasuar me shifrat e këtij viti, numrat e dekadës së fundit kanë qenë shumë më të ulët. Për shembull, në vitin

2018 kanë humbur jetën 9 400 persona si pasojë e të nxehtit, ndërsa në vitin 2019 kanë vdekur 7 700 të tjerë për shkak të temperaturave të larta. Raporti i së enjtes përfshin periudhën nga 6 prilli deri më

2 gusht, shkruan "Yahoo".

RKI-ja ka deklaruar se shifrat e saj janë vlerësime konservatore, ndaj numri i përgjithshëm i vdekjeve të lidhura me të nxehtin këtë vit mund të jetë edhe më i lartë.



ZGJEDHJET E 7 QERSHORIT VLERËSOHEN TË LIRA DHE KONKURRUESE, POR KËRKOHET HETIM PËR VOTIMIN JASHTË VENDIT

PRISHTINË, 13 GUSHT - Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit janë vlerësuar përgjithësisht në përputhje me standardet demokratike për zgjedhje të lira, konkurruese dhe të drejta, ndërsa nuk janë evidentuar probleme që do ta cenonin integritetin e përgjithshëm të procesit. Këto vlerësime janë bërë në konferencën “Forcimi i integritetit zgjedhor: gjetjet dhe rekomandimet nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2026”, të organizuar nga koalicioni i organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve “Demokracia në Veprim” (DnV). Sipas vlerësimeve të DnV-së, administrimi i zgjedhjeve ishte përgjithësisht profesional dhe teknikisht më i mirë se në proceset e mëparshme. Megjithatë, janë evidentuar sfida në qasjen në vendvotime, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara, në zbatimin konsistent të procedurave si dhe në mjedisin digjital informativ. Zëvendësambasadori i Zvicrës, Christoph Fuchs, ka thënë se zgjedhjet janë zhvilluar në një

mjedis të qetë, konkurrues dhe paqësor, duke vlerësuar punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). “Zgjedhjet e fundit janë bërë në një mjedis të qetë, kompetitiv dhe paqësor. KQZ ka administruar shumicën e rasteve profesionalisht dhe PZAP, po ashtu, ka treguar profesionalizëm. Këto janë arritjet e rëndësishme. Raportet tregojnë për vështirësi në gjetjen e pikave të votimit, mungesa në qasje për persona me aftësi të kufizuara dhe aplikim konsistent i procedurave dhe sfidat në mjedisin digjital informativ”, ka thënë Fuchs. Ai ka theksuar se këto nuk janë vetëm çështje teknike, por lidhen edhe me besimin e qytetarëve në procesin zgjedhor dhe në institucione. “Qytetarët duhet të besojnë se ligjet aplikohen për të gjithë paralelisht dhe se vota është e mbrojtur dhe e fshehur. Zgjedhjet nuk i zëvendësojnë institucionet funksionale, aktorët politikë duhet të jenë në gjendje të mos pajtohen, pa



lejuar që të parandalohet funksionalizimi institucional. Dalja e ulët në votim ka theksuar nevojën për institucione efektive”, ka thënë ai. Ndërsa Eugen Cakolli nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka deklaruar se zgjedhjet e 7 qershorit kanë qenë teknikisht më të mira se proceset paraprake por, sipas tij, në aspektin politik ato dëshmojnë se vendi po shkon në zgjedhje si pasojë e krizave që nuk po zgjidhen përmes proceseve politike. “Zgjedhjet e 7 qershorit janë zhvilluar përgjithësisht në përputhje me standarde

demokratike për zgjedhje të lira, konkurruese dhe të drejta. Administrimi i procesit ishte në përgjithësi profesional dhe DnV-ja nuk ka evidentuar probleme që do ta cenonin integritetin e përgjithshëm të zgjedhjeve”, ka thënë Cakolli. Ai ka vlerësuar se KQZ-ja në pjesën dërrmuese e ka administruar procesin në mënyrë më profesionale sesa në proceset e mëparshme. “Teknikisht këto zgjedhje ishin dukshëm më të mira se ato që lamë pas, por politikisht këto zgjedhje janë dëshmi se vendi po hyn në zgjedhje për shkak të

krizave që nuk zgjidhen përmes zgjedhjeve”, ka thënë Cakolli. Sa i përket votimit jashtë vendit, Cakolli ka thënë se ky proces ka qenë më pak i politizuar dhe më i rregullt, por ka mbetur një çështje që kërkon trajtim nga institucionet e hetuesisë. “Ndonëse procesi i votimit jashtë vendit ka qenë më pak i politizuar dhe më i rregullt, mbetet një çështje serioze, e cila kërkon trajtim nga ana e institucioneve të hetuesisë, që ndërlidhet me rastet e publikimit në rrjete sociale të grupeve të organizuara të votuesve që plotësonin numër të madh të fletëvotimeve”, ka thënë ai. Në mesin e çështjeve që kërkojnë trajtim të mëtejshëm është përmendur edhe votimi jashtë vendit. DnV-ja ka ngritur shqetësimin lidhur me publikimet në rrjetet sociale, ku pretendohet se grupe të organizuara votuesish kanë plotësuar një numër të madh të fletëvotimeve, duke kërkuar që këto raste të trajtohen nga institucionet përkatëse të hetuesisë.

RAMA: UKRAINA E KA GABIM PËR KOSOVËN, POR SHQIPËRIA DO TË VAZHDOJË TA MBËSHTESË

TIRANË, 13 GUSHT - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka reaguar në platformën “X” pas deklaratës së presidentit ukrainas, Volodymyr Zelensky, se Ukraina nuk do ta njohë Kosovën. Rama ka thënë se qëndrimi i Ukrainës ndaj Kosovës nuk duhet të ndikojë në mbështetjen e Shqipërisë për popullin ukrainas dhe të drejtën e tij për liri. Ai i ka kritikuar ata që, pas deklaratës së Zelenskyt, kanë kërkuar që Shqipëria ta ndryshojë qëndrimin ndaj Ukrainës, duke theksuar se mbështetja për një popull që përballat me luftë nuk mund të kushtëzohet nga përfitimet politike.



“Miku im i dashur, Volodymyr Zelensky, qëndroi në Beograd dhe tha se Ukraina nuk do ta njohë kurrë Kosovën. Brenda një ore, nacionalistët më të zëshëm

popullistë në Tiranë dhe Prishtinë nisën të bëjnë llogaritë gjeopolitike: ndoshta duhet ta ndëshkojmë Ukrainën, të mos e mbështesim më të lirën dhe të

mos vajtojmë për viktimat e bombardimeve. Më të pamaturit prej tyre na sulmuan pse nuk hoqëm dorë nga Ukraina. Madje, disa brohoritën për Rusinë!”, ka shkruar Rama. Ai ka theksuar se mbështetja ndaj Ukrainës nuk është çështje shkëmbimi politik, por parim në mbështetje të lirisë dhe paqes. “Çfarë turpi të humbasësh nga sytë të vërtetën e thjeshtë se liria nuk funksionon me kthim shpërblimesh”, ka shkruar Rama. Sipas tij, qëndrimi kundër një lufte agresioni dhe në mbështetje të një paqeje të drejtë nuk mund të ndryshojë për shkak të një qëndrimi politik të palës së mbështetur.

“Ukraina mund të jetë dhe po, ajo e ka gabim për Kosovën, por e drejta e saj për të qenë e lirë mbetet e padiskutueshme. Të luftosh për këtë të drejtë do të thotë të luftosh për Evropën dhe për veten tonë gjithashtu”, ka shkruar Rama. Rama ka thënë se këto dy qëndrime mund të bashkëtojnë dhe se Shqipëria do të vazhdojë ta mbështesë Ukrainën. “Këto të vërteta mund të bashkëtojnë fare mirë në të njëjtën fjalë. Shqipëria është mjaftueshëm e pjekur për t'i mbajtur të dyja dhe do t'i mbajë. Pra, po: UKRAINË E LIRË. Sot, nesër dhe gjithmonë”, ka shkruar Rama.

Gjermania dhuron rreth 3 milionë euro për avancimin e kapaciteteve të FSK-së

PRISHTINË, 13 GUSHT - Gjermania ka dhuruar rreth 3 milionë euro për avancimin e kapaciteteve operacionale të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Në kuadër të bashkëpunimit bilateral ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë, sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, Gafurr Dugolli, dhe atasheu gjerman i mbrojtjes në Kosovë, nënkolonel Guido Altendorf, kanë nënshkruar marrëveshjen për projektin e donacionit gjerman “Enable & Enhance Initiative”.

Sipas njoftimit të Ministrisë së Mbrojtjes, projekti synon avancimin e kapaciteteve operacionale të FSK-së, në funksion të përmbushjes së misionit të saj. “Ky projekt është vazhdimësi e projekteve të realizuara deri më tani në kuadër të bashkëpunimit dypalësh ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë”, është thënë në njoftimin e ministrisë. Me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes, Dugolli ka shprehur mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme



të Gjermanisë ndaj Kosovës, duke theksuar rëndësinë e

bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Ai ka shprehur besimin se bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve do të vazhdojë edhe përmes projekteve të tjera. Në takim kanë marrë pjesë edhe drejtori i Departamentit për Logjistikë dhe Infrastrukturë në Ministrinë e Mbrojtjes, kolonel Imer Avdiu, e ngarkuara me punë në Ambasadën e Gjermanisë në Kosovë, Silke Bellmann, si dhe përfaqësuesit e Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT), nënkolonel Fabian Vogl dhe major Claus Schumm.

PDK-ja DHE ALEANCA RRISIN PRESIONIN PËR KONSTITUIMIN E KUVENDIT, AKUZAT NDAJ KURTIT PËR UZURPIM THELLOHEN

PDK-ja dhe Aleanca kanë shtuar presionin politik për konstituimin e Kuvendit, duke dorëzuar kërkesë zyrtare për vazhdimin e seancës konstituive. Deputetët e PDK-së kanë zhvilluar një aksion simbolik para qeverisë dhe në Kuvend. Kjo parti ka kërkuar që procesi të vazhdojë pa u kushtëzuar me marrëveshjen për presidentin. Deputeti i PDK-së, Enver Hoxhaj, e ka akuzuar Albin Kurtin se po qëndron në zyrën e kryeministrit pa legjitimitet, ndërsa Vlora Çitaku ka kërkuar që ai të kthehet në Kuvend për ta konstituuar institucionin dhe për ta formuar qeverinë.

EPOKA E RE**Lirim GECI**

Prishtinë, 13 gusht - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka vazhduar të enjten aksionet në shenjë kundërshtimi ndaj moskonstituimit të Kuvendit të Kosovës, mes të cilave ka dorëzuar edhe zyrtarisht një kërkesë për thirrjen e seancës konstituive sot (e premte) në orën 11:00. Edhe Aleanca nëpërmjet deputetit Besnik Tahiri ka kërkuar që seanca konstituive të mbahet në të njëjtën kohë.

Aksionet e së enjtes kanë filluar me qëndrimin e disa deputetëve të saj para ndërtesës së qeverisë, ku akuzuan kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, se po “uzurpon” institucionin dhe kërkuar që ai të kthehet në Kuvend.

Më vonë, deputetët e PDK-së janë zhvendosur në objektin e Kuvendit, prej ku deputeti i kësaj partie, Përparim Gruda, ka njoftuar për dorëzimin e kërkesës edhe zyrtarisht.

Aksionet e PDK-së janë pjesë e presionit që kjo parti, bashkë me Aleancën, po ushtron për vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit dhe përfundimin e procesit të themelimit të legjislaturës së re.

Edhe përfaqësues të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) kanë insistuar në respektimin e afateve dhe procedurave kushtetuese, por nuk kanë marrë në pjesë në aksionet e këtyre dy ditëve.

LDK-ja është partia e vetme që ka zhvilluar disa takime me LV-në për një marrëveshje të mundshme. Kosova mbetet pa Kuvend të konstituuar pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 7 qershorit. Rezultatet e këtyre zgjedhjeve u certifikuan më 8 korrik, ndërsa

afati 30 ditor për konstituimin e Kuvendit përfundoi më 7 gusht. Lidhur me këtë afat, 14 organizata joqeveritare iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese të mërkurën. Seanca konstituive ishte caktuar të niste më 6 gusht. Megjithatë, procesi është ndërprerë pasi Kurti, në cilësinë e kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, ka kërkuar kohë shtesë për diskutime me partitë politike lidhur me zgjedhjen e presidentit të ardhshëm. Kurti ka argumentuar se konstituimi i Kuvendit pa një marrëveshje paraprake për presidentin do ta çonte vendin drejt zgjedhjeve të tjera të parakohshme.

Hoxhaj: Kurti nuk është kryeministër, por deputet uzurpator i zyrës së kryeministrit

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, e ka cilësuar “absurde” situatën aktuale politike në Kosovë, duke e akuzuar qeverinë në detyrë se po vazhdon të ushtrrojë funksionin në kundërshtim me Kushtetutën.

Hoxhaj ka thënë se Kosova ka kaluar nëpër tri palë zgjedhje nacionale ndërsa, sipas tij, nuk ka ndodhur më parë që një qeveri dhe ministrit të qëndrojnë për kaq gjatë në detyrë. “Kjo se çfarë po ndodh në këtë vend është absurde dhe nuk ka ndodhur asnjëherë në historinë e Kosovës. Ne kemi pasur zgjedhje në shkurt, ne kemi pasur zgjedhje në dhjetor, ne kemi pasur zgjedhje në qershor. Kemi pasur tri palë zgjedhje nacionale. Datat i dini. Asnjëherë nuk ka ndodhur në historinë e Kosovës që dikush, 18 muaj e 4 ditë, 18 muaj e 5 ditë, të qëndrojnë në zyrat e kryeministrit dhe ministrit të qëndrojnë në zyrat e tyre duke shkelur



Kushtetutën e Kosovës, nenin 72”, ka thënë ai gjatë aksionit të PDK-së të mbajtur para qeverisë.

Hoxhaj, duke iu referuar përvojës së tij si ministër, ka thënë se pas certifikimit si deputet e ka lënë postin ministror. “Unë kam qenë katër herë anëtar i qeverisë. Sa herë jam betuar për deputet, sa herë jam certifikuar për deputet, e kam lëshuar zyrën si ministër i Jashtëm dhe kam mbetur vetëm deputet i Kuvendit të Kosovës. Kjo çfarë po ndodh në këtë vend në këta 18 muajt e fundit dhe në javën e fundit është që ne nuk e kemi një qeveri legjitime më. Qeveria nuk është legjitime. Ky zotëri nuk është kryeministër. Ky është një deputet zaptues, një deputet uzurpator i cili e ka uzurpuar zyrën e kryeministrit, i cili merr vendime në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, në kundërshtim me Ligjin për Qeverinë”, ka thënë ai.

Deputeti i PDK-së ka kërkuar rikthimin e rendit kushtetues dhe

ka bërë thirrje që seanca e Kuvendit të thirret.

Ndërsa deputetja e PDK-së, Vlora Çitaku, e ka akuzuar kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, se po i “uzurpon” zyrat e qeverisë dhe ka thënë se ai duhet të jetë në Kuvend, bashkë me deputetët, për ta konstituuar këtë institucion dhe për ta formuar qeverinë. “Ne këtu kemi me një qëllim të vetëm: të kërkojmë rivendosjen e ligjit, Kushtetutës dhe demokracisë në vend. Kjo ndërtesë këtu është Qeveria e Republikës së Kosovës, në të cilën edhe unë, edhe profa Enver, e shumë prej nesh kemi pasur nderin të shërbejmë. Nuk ka privilegj e nder më të madh sesa për t’i shërbyer vendit tënd, mirëpo edhe nuk ka krim më të madh sesa kur besimi i qytetarëve keqpërdoret dhe zyrat e popullit uzurpohen. Këto zyra janë të uzurpuara nga një deputet. Po aq sa ka të drejtë ai të jetë aty, po aq kemi të drejtë edhe ne. Kjo është e para. E dyta, ai duhet të jetë në

Kuvend, bashkë me ne, për t’i themeluar institucionet, për ta konstituuar Kuvendin. Nuk jemi ne këtu të bëjmë puç. Ne jemi këtu për t’i thënë Albin Kurtit dhe zotërisë: Eja në Kuvend, shumicën e ke, ndërroje qeverinë dhe ecim tutje. Por ai njeri jashtëligjshëm, pa asnjë lloj mbikëqyrje parlamentare, mbrëmë vonë ka marrë vendime. Kush janë ata që marrin vendime, me çfarë mandati, këtu në ndërtesë të qeverisë? Pra, ne jemi këtu për t’i thënë Albin Kurtit: eja në Kuvend, aty e ke vendin, t’i ndërtojmë institucionet e të ecim tutje”, ka thënë ajo.

Tahiri i Aleancës: Jemi në emergjencë kombëtare

Deputeti i Aleancës, Besnik Tahiri, ka thënë se situata aktuale paraqet, sipas tij, “emergjencë kombëtare” dhe tendencë për shkatërrimin e rendit kushtetues.



TITULLARËT SHTETËRORË, ME LEGJITIMITET TË KONTESTUAR

PRISHTINË, 13 GUSHT - Tri institucionet kryesore në Kosovë udhëhiqen prej muajsh nga zyrtarë që ose janë në detyrë, ose janë ushtrues detyre. Pas betimit të deputetëve të legjislaturës së 11-të të Kuvendit të Kosovës, më 6 gusht legjitimiteti i titullarëve shtetërorë është vënë në pikëpyetje.

Albin Kurti është kryeministër në detyrë që nga shpërbërja e Kuvendit, që çoi në zgjedhjet e parakohshme të 7 qershorit, ndërkaq kryeparlamentarja e legjislaturës së dhjetë, Albulena Haxhiu, është ushtruese e detyrës së presidentit që nga 4 prilli, pas mbarimit të mandatit pesëvjeçar të Vjosa Osmanit në krye të shtetit.

Megjithatë, si Kurti, ashtu edhe Haxhiu, kanë bërë betimin si deputetë të legjislaturës së re më 6 gusht, dhe pikërisht vazhdimi i mbajtjes së posteve në Qeveri, Kuvend dhe Presidencë, pas betimit si deputetë, sipas vëzhguesve, përbën shkelje.

Vullnet Bugaqku nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe Ema Pula nga Grupi për Studime Politike dhe Juridike (GLPS) vlerësojnë se Kurti, por edhe anëtarët e tjerë të ekzekutivit që janë betuar deputetë, po shkelin një dispozitë të Ligjit për Qeverinë, pasi argumentojnë se ata do të duhej të jepnin dorëheqje nga postet ekzekutive pas zgjedhjes deputetë. “Një zyrtar publik njëkohësisht nuk mund të jetë deputet i zgjedhur, i betuar tashmë, të jetë edhe kryeministër, qoftë edhe në detyrë, ose ministër në detyrë”, vlerëson Bugaqku për “Radion Evropa e Lirë”.

Pula ka thënë se duke pasur për bazë parimin e ndarjes së pushteteve, anëtarët e qeverisë që janë zgjedhur deputetë nuk mund të ushtrojnë edhe poste ekzekutive, pra “rrjedhimisht

nuk mund të marrin edhe vendime në nivel ekzekutiv”. Kurti ishte edhe më herët kryeministër në detyrë, pas zgjedhjeve të shkurtit të vitit të kaluar, të cilat u pasuan me një krizë politike, kur deputetët për muaj të tërë nuk arritën t’i formonin institucionet e reja të vendit në mungesë të një konsensusi.

Kompetencat e qeverisë në detyrë kufizohen me Ligjin për Qeverinë. Aty thuhet se ekzekutivi në detyrë kryen vetëm aktivitetet e domosdoshme të planifikuara në planin vjetor të punës dhe me Ligjin Vjetor për Buxhetin. Qeveria në detyrë, mes të tjerash, nuk lejohet: të miratojë nisma për marrëveshje ndërkombëtare për të cilat kërkohet ratifikim nga Kuvendi, të miratojë projekt-amendamente kushtetuese, projektligje, strategji dhe koncept dokumente, të iniciojë procedura të reja për emërimin në pozitat publike.

Pas betimit deputet, Kurti në një konferencë për medie është zotuar se do t’i respektojë kufizimet e përcaktuara në ligj, por është shprehur se do të vazhdojë ta mbajë pozitën e kryeministrit në detyrë. “Unë vazhdoj të jem kryeministër në detyrë dhe do ta respektoj në përpikëri kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, përfshirë këtu edhe Ligjin mbi Qeverinë”, ka thënë ai.

Bugaqku nga KDI ka thënë se vendimet e zyrtarëve që janë ushtrues detyre “shumë lehtë” mund të kontestohen në gjykata dhe ato të anulohen, duke bërë që, sipas tij, të jetë i cenueshëm edhe parimi i sigurisë juridike në vend “për shkak se vendimet po merren nga personat që s’janë të autorizuar tashmë t’i ndërmarrin ato vendime”.



Megjithatë, për Bugaqkun dhe Pulën më problematike është çështja e ushtrimit të detyrës së presidentit nga kryeparlamentarja e legjislaturës së kaluar, Haxhiu, pas betimit deputete më 6 gusht. “Në rastin konkret, meqenëse zonja Haxhiu është betuar deputete, nuk ekziston më një bazë kushtetuese për vazhdimin e ushtrimit të detyrës së presidentit nga ajo, pasi ushtrimi i kësaj detyre lidhet drejtpërdrejt me mbajtjen e pozitës së kryetarit të Kuvendit”, ka thënë Pula nga GLPS.

Ligji për Presidentin përcakton se posti i ushtrueses së detyrës së presidentit mund të ushtrohet jo më gjatë se gjashtë muaj, që i bie Kosova mund të ketë u. d. të presidentit deri më 4 tetor. Bugaqku ka thënë se udhëheqja e shtetit nga funksionarë që nuk kanë legjitimitet të plotë është e paprecedentë dhe e papranueshme. “Kjo nuk i bën nder as shtetit, por as qytetarëve të Kosovës, sepse institucionet kryesore të shtetit pra, Kuvendi, Qeveria dhe Presidenca, po vazhdojnë të jenë pa titullarët legjitimë që i mbajnë këto pozita”, ka thënë ai. Ai është shprehur se do të duhej të kishte një interpretim të ri të Gjykatës Kushtetuese ku do të sqarohet legjitimiteti i mbajtjes së

pozitave të kryetarit të Kuvendit e të deputetëve. “Tashmë është diskutabile dhe shumë i dyshimtë aspekti i vendimmarrjes edhe i rolit, sjelljes, që mund ta ketë kryetarja e Kuvendit duke qëndruar njëkohësisht edhe si ushtruese e detyrës së presidentes, sepse Kuvendi i Kosovës nuk është konstituuar brenda afatit kushtetues. Rrjedhimisht, nuk e dimë ende se sa janë të vlefshme tashmë edhe mandatet e këtyre deputetëve”, ka thënë ai. Kurti dhe Haxhiu vazhdojnë të mbajnë të tri postet kryesore shtetërore, teksa legjislatura e re ende nuk ka përmbyllur konstituimin e organit ligjvënës. Sipas një aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese, të publikuar në qershorin e vitit të kaluar, deputetët duhet ta konstituojnë Kuvendin, pra ta zgjedhin kryetarin dhe pesë nënkryetarët e tij brenda 30 ditësh nga data e certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve të qershorit. Kjo datë skadoi mesnatën e 7 gushtit, por Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit, që ka fituar zgjedhjet e qershorit, argumenton se ky afat ka nisur më 6 gusht, kur ka nisur seanca konstituive. Kurti ka refuzuar ta propozojë kandidatin për kryeparlamentar, teksa ka kërkuar një marrëveshje me subjektet politike për

çështjen e presidentit - moskonsensusi për të cilin shkaktoi zgjedhjet e qershorit. Lidhur me çështjen e afatit për konstituim, disa organizata joqeveritare i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese që të ndërmarrë veprime lidhur me aktgjykimin e saj për këtë çështje. Teksa Kosova po përballet me kriza të njëpasnjëshme institucionale dhe politike, pasi që nga shkurti i vitit 2025 ka mbajtur tri herë zgjedhje parlamentare dhe sërish qytetarët mund t’u drejtohen kutive të votimit në rast të moszgjedhjes së presidentit të ri, Pula nga GLPS ka thënë se këto kriza kanë ndikuar drejtpërdrejt në funksionimin e institucioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre kushtetuese e ligjore. Sipas saj, mosfunksionimi formal i institucioneve prodhon pasoja të drejtpërdrejta dhe afatgjata për qytetarët. “Zvarritja e funksionimit të institucioneve pengon marrjen e vendimeve të nevojshme, vonon reformat si dhe kufizon aftësinë e institucioneve për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave dhe problemeve të qytetarëve”, ka thënë Pula për “Radion Evropa e Lirë”.

Ajo është shprehur se, përveç ndikimit brenda vendit, kriza institucionale dobëson edhe pozitën e shtetit në aspektin ndërkombëtar, “duke cenuar kredibilitetin e saj si partner, duke vështirësuar avancimin e agjendës së saj evropiane, por edhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare”. Një pasojë e mundshme, nëse vendi s’arrin të ketë institucione të reja, mund të jetë humbja e përhershme e milionave që Bashkimi Evropian ka ndarë për Kosovën në kuadër të Planit të Rritjes.

“Rrethana të cilat jemi si Kosovë dhe rrethana në të cilat është sot Kuvendi i Republikës së Kosovës, tregojnë jo vetëm për një emergjencë kombëtare, mirëpo për një tendencë të shkatërrimit të rendit kushtetues, njëkohësisht të pamundësisimit të ushtrimit të funksionit të deputetit në Kuvendin e Kosovës aty ku na ka dhënë besimin sovran, aty ku ne kemi vendin bazë të qytetarëve të Republikës së Kosovës”, ka thënë Tahiri në një konferencë për medie. Ai ka bërë me dije se Aleanca, në koordinim me partitë politike që kanë qenë në opozitë, ka kërkuar takim me kryesuesin e seancës konstituive, Avni Dehari, me qëllim që seanca të mbahet në orën 11:00.

Tahiri ka thënë se partitë opozitare fillimisht do t’i ndjekin rrugët institucionale, ndërsa ka paralajmëruar edhe veprime politike në rast se, siç ka thënë ai, vazhdon pamundësimi i ushtrimit të mandatit të deputetëve. “Kur neve na pamundësohet ushtrimi i



funksionit tonë si deputetë, dhe kur ne e shohim që ka nisur shpërbërja e institucioneve demokratike që fillojnë nga Kuvendi, rrjedhimisht shkatërrimi i të arriturave të vendit tonë, nuk na mbetet tjetër veçse të provojmë rrugë fillimisht institucionale, pastaj t’i bëjmë veprimet tona politike në funksion të krijimit të rendit kushtetues në Kosovë”, ka thënë Tahiri.

Ai ka shprehur shqetësim edhe për funksionimin e qeverisë, duke pretenduar se shkeljet kushtetuese po ndodhin edhe në këtë institucion. “Ajo që na brengos shumë është se shkelja e Kushtetutës nuk po ndodh vetëm në Kuvend, por po ndodh edhe në qeveri. I kemi 17 ministra që shkojnë jashtëligjshëm në qeveri. Prokuroria duhet të veprojë”, ka thënë Tahiri.

Kuvendi fajëson deputetët e PDK-së dhe të Aleancës që kanë ndër- prerë vizitën e mërgim- tarëve

Kuvendi i Kosovës ka lëshuar një komunikatë për medie lidhur me zhvillimet e së mërkurës në Kuvendin e Kosovës. Sipas Zyrës për Medie të këtij institucioni, deputetët e PDK-së dhe të AAK-së e kanë ndërprerë për disa minuta vizitën e mërgimtarëve në Kuvend pasi, sipas saj, kishin zënë sallën plenare në një kohë kur nuk ishte thirrur asnjë seancë. Sipas Kuvendit të Kosovës, rreth një mijë bashkatdhetarë nga vende të ndryshme të botës e vizituan organin legjislativ në kuadër të aktivitetit të përvitshëm “Bashkatdhetarët në Kuvend”. “Edhe sot bashkatdhetarët u pritën nga kryetarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, u. d. presidente Albulena Haxhiu, në ambientet e punës së Kuvendit.

Gjatë qëndrimit ata u pritën gjithashtu nga deputetë dhe zyrtarë të administratës së Kuvendit, të cilët i shoqëruan gjatë vizitës dhe i informuan më nga afër për punën, funksionimin, përgjegjësitë dhe rolin e Kuvendit si institucioni më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës i Republikës së Kosovës. Po ashtu, bashkatdhetarët patën mundësi të njihen drejtpërdrejt me hapësirat e Kuvendit, përfshirë sallën plenare, si dhe me historikun, veprimtarinë dhe rëndësinë e këtij institucioni në jetën demokratike të vendit. Në ditën e tretë, vizita në sallën plenare u ndërpre për disa minuta, pasi deputetë të PDK-së dhe të AAK-së kishin zënë sallën plenare në një kohë kur nuk ishte thirrur asnjë seancë”, është thënë në komunikatë.

Kjo komunikatë është kritikuar nga deputetë të PDK-së të cilët kanë thënë se administrata e Kuvendit është instrumentalizuar nga IV-ja. Deputetë të PDK-së dhe të Aleancës të mërkurën kanë qëndruar në Kuvend, ku ka pasur ballafaqime dhe përplasje me deputetë të IV-së.

Policia e Kosovës ndan mbi 45 mijë euro për renovimin e qendrave të ndalimit në Gjakovë

GJAKOVË, 13 GUSHT - Policia e Kosovës ka dhënë një kontratë në vlerë prej 45 257.20 eurosh për renovimin e qendrave të ndalimit në kuadër të stacioneve policore në regjionin e Gjakovës. Sipas njoftimit për dhënie të kontratës, aktiviteti i prokurimit me titull “Renovimi i

qendrave të ndalimit në kuadër të stacioneve policore” ka pasur vlerë të parashikuar prej 114 134.98 eurosh dhe është zhvilluar përmes procedurës së hapur, me kriter të dhënies çmimin më të ulët. Kontrata për regjionin e Gjakovës, e cila përbën pjesën e

tretë të aktivitetit, i është dhënë kompanisë “MBB Construction Sh. P.K.”, me adresë në Prizren. Për këtë pjesë kanë konkurruar dy operatorë ekonomikë. Sipas dokumentit, punët do të realizohen në qendrat e ndalimit sipas paramasës së përcaktuar nga Autoriteti


Kontraktues. Përveç Gjakovës, pjesë të tjera të kësaj procedure të prokurimit janë edhe stacionet në regjionin e Prizrenit, Pejës dhe Prishtinës. Një nga një, së shpejti pritet të përmbyllen aktivitetet e prokurimit edhe për këto regjione.



ARRESTOHET NJË PERSON NË MERDAR NËN DYSHIMIN PËR SPIUNAZH

PRISHTINË, 13 GUSHT - Policia e Kosovës ka arrestuar dhe ndaluar për 48 orë shtetasin e Kosovës, Fehim Sali, nën dyshimin për kryerjen e veprës penale të spiunazhit. Sipas njoftimit, arrestimi është kryer në pikën kufitare në Merdar të Podujevës me urdhër të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Fehim Sali, i cili vjen nga komuna e Dragashit është i angazhuar në sistemin arsimor serb brenda Kosovës. Ai ishte edhe pjesë e Këshillit Konsultativ për Komunitete (KKK) brenda Presidencës së Kosovës, i emëruar më 2022. Policia dhe Prokuroria Speciale nuk kanë dhënë hollësi se për çfarë aktiviteteve saktësisht dyshohet ai dhe as nëse rasti lidhet me ndonjë shërbim të huaj të inteligjencës. Prokuroria Speciale ka thënë se, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, do t'i vazhdojë veprimet hetimore për zbardhjen e plotë të rrethanave të rastit. Në këtë kontekst, hetuesit policorë nga Drejtoria

për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda kanë zbatuar urdhërkontrollin në vendbanimin e të dyshuarit në Dragash, ku kanë sekuestruar rreth 40 mijë euro, katër telefona celularë dhe dokumente të ndryshme relevante për rastin. Në Kosovë, spiunazhi përfshin aktivitete sekrete të mbledhjes, transmetimit ose shpërndarjes së informacionit të ndjeshëm të një shteti, organizatë ose grup tjetër. Sipas Kodit Penal të Kosovës, spiunazhi konsiderohet veprë e rëndë penale dhe, në rast të shpalljes fajtor, mund të dënohet me të paktën pesë vjet burgim. Ky arrestim vjen në një periudhë kur autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë disa raste hetimore dhe arrestime nën dyshimet për spiunazh në favor të inteligjencës serbe. Në raste të mëparshme janë arrestuar persona nga komunitete të ndryshme në Kosovë, nën dyshimet se kanë mbledhur apo përcjellë



informacione për shërbimet serbe të inteligjencës. Ekspertë të sigurisë kanë vlerësuar se spiunazhi paraqet kërcënim serioz për sigurinë e Kosovës.

Sipas tyre, veprimtari të tilla mund të ndikojnë në sigurinë e brendshme, t'i destabilizojnë institucionet dhe ta dëmtojnë pozitën ndërkombëtare të

Kosovës. Autoritetet nuk kanë bërë me dije nëse rasti i Fehim Sali është i ndërlidhur me ndonjë prej rasteve të mëparshme të spiunazhit.

PROKURORIA NGRE AKTAKUZË NDAJ PESË PERSONAVE PËR ZJARRIN NË “GATE CLUB”

PRISHTINË, 13 GUSHT - Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë ndaj pesë personave për zjarrin në “Gate Club”. Sipas njoftimit të prokurorisë, personat me inicialet Sh. T. dhe F. S. dyshohen për veprën penale “Zjarrvënia”, ndërsa tre të tjerë për veprën penale “Shtytje nga zjarrvënia”. “Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, njofton opinionin publik se, pas zhvillimeve hetimore, mbledhjes dhe analizimit të provave, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve Sh.T. dhe F.S., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se kanë kryer veprën penale ‘Shtytje nga zjarrvënia’, nga neni 322, paragrafi 3, lidhur me



nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), ndaj të pandehurve B.H., I.M. dhe Rr.A., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se kanë kryer veprën penale ‘Shtytje nga zjarrvënia’, nga neni 322, paragrafi 3, lidhur me nenin 32

të KPRK-së, si dhe ndaj të pandehurit F.S., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale ‘Pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare’, nga neni 386, paragrafi 1, lidhur me nenin 28 të KPRK-së”, është thënë në njoftim.

Sipas aktakuzës, zjarri i është vënë diskotekës rreth orës 04:53 dhe dëmi material është në vlerë prej 969.435 euro. “Sipas aktakuzës, më datë 14.02.2025, rreth orës 04:53, në rrugën ‘Epiri’, në zonën industriale Prishtinë-Fushë Kosovë, në objektin e diskotekës ‘Gate Club’, të pandehurit Sh.T. dhe F.S., në bashkëkryerje dhe me dashje, pas shtyrjes nga i pandehuri Rr.A. dhe në këmbim të shpërblimit prej 3.000 eurosh, i kanë vënë zjarrin objektit të diskotekës ‘Gate Club’ dhe, si pasojë e këtij veprimi, të dëmtuarve u është shkaktuar dëm material në vlerë prej 969.435 euro”, është thënë më tutje në njoftimin e prokurorisë.

Sipas aktakuzës, qëllimi i këtij veprimi ka qenë hakmarrja, pasi të pandehurit konsideronin se F. S. dhe Sh. T. ishin arrestuar si rezultat i veprimeve të të dëmtuarit S. S. Personat e shtyrë, sipas Prokurorisë, e kanë realizuar veprimin e paralajmëruar duke i vënë zjarrin automjetit “Range Rover” të të dëmtuarit S. S., me ç'rast është shkaktuar dëm material në vlerë prej 54.892,72 eurosh. Lidhur me rastin, prokurori i çështjes i ka propozuar Gjykatës Themelore në Prishtinë që, pas shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, t'i shpallë fajtorë për veprat penale që u vihen në barrë dhe t'i dënojë sipas legjislacionit në fuqi.

118 gjoba të shqiptuara gjatë korrikut për mbipeshë të mjeteve të rënda

PRISHTINË, 13 GUSHT - Gjatë muajit korrik 2026 janë shqiptuar 118 gjoba për mbipeshë të mjeteve të rënda. Sipas njoftimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe

Transportit, vlera e përgjithshme e gjobave të shqiptuara gjatë këtij muaji është 68 mijë e 740 euro. “Vetëm gjatë muajit korrik 2026 janë shqiptuar 118 gjoba, në

vlerë të përgjithshme prej 68 740 eurosh, prej të cilave 3 900 euro ndaj personave fizikë dhe 64 840 euro ndaj personave juridikë (kompanive)”, është thënë në njoftim. Me këtë rast,

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit u ka bërë thirrje mjeteve dhe kompanive transportuese që t'i respektojnë kufizimet e lejuara të peshës.



IKD-ja DHE GLPS-ja: QEVERIA NË DETYRË PO VEPRON NË KUNDËRSHTIM ME KUSHTETUTËN DHE LIGJIN

PRISHTINË, 13 GUSHT - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) kanë vlerësuar se vendimmarrja e qeverisë në detyrë është në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

IKD-ja ka vlerësuar se vendimet e miratuara më 12 gusht 2026 nga qeveria në detyrë përbëjnë cenim serioz të rendit kushtetues dhe funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës. IKD-ja ka thënë se qeveria, e përbërë nga persona të zgjedhur deputetë, të cilët nuk kanë dhënë dorëheqje nga funksionet ekzekutive, ka vazhduar të ushtrojë pushtet sikur të kishte mandat të plotë. Sipas saj, parimet e sundimit të ligjit nuk tolerojnë që pushteti të ushtrohet duke abuzuar me ligjin, pasi ai duhet të ushtrohet vetëm brenda kufijve që përcaktojnë Kushtetuta dhe ligji. IKD-ja ka vlerësuar se Neni 72 i Kushtetutës është i qartë: deputeti i Kuvendit nuk mund të mbajë post ekzekutiv e as të ushtrojë funksion tjetër ekzekutiv. Kjo dispozitë përcakton papajtueshmëri të drejtpërdrejtë ndërmjet mandatit të deputetit dhe funksionit ekzekutiv. Nga momenti i marrjes së mandatit të deputetit, vazhdimi i ushtrimit të kompetencave qeveritare bie ndesh me ndalesën kushtetuese dhe e vë në pikëpyetje ligjshmërinë e vendimeve të marra.

Sipas nenit 26 të Ligjit për Qeverinë, anëtarët e qeverisë në detyrë që janë zgjedhur deputetë është dashur të japin dorëheqje nga postet qeveritare para certifikimit të rezultateve. Megjë nuk e kanë bërë këtë, vazhdimi i ushtrimit të funksioneve ekzekutive është në kundërshtim me ligjin. “Megjithatë, më 12 gusht, kjo qeveri ka zhvilluar mbledhje elektronike dhe ka marrë një varg vendimesh me pasoja juridike, institucionale, pronësore dhe buxhetore. Ajo ka vendosur për qiradhënie të pronës publike deri në vitin 2033, procedura që lidhen me shpronësimin, ndarje të mjeteve financiare dhe çështje të tjera që prodhojnë pasoja përtej administrimit të zakonshëm. Qytetarët duhet ta kuptojnë qartë se persona që ligji nuk i lejon të vazhdojnë si anëtarë të Qeverisë po marrin vendime në emër të shtetit dhe po krijojnë detyrime që mund të rëndojnë institucionet edhe për shumë vite”, është thënë në reagimin e IKD-së.

Sipas IKD-së, shkelja bëhet edhe më e rëndë me vendimet për emërimin e komisioneve të pranimit për një numër të madh pozitash të larta drejtuese. “Neni 31 i Ligjit për qeverinë ia ndalon shprehimisht qeverisë në dorëheqje iniciimin e



procedurave të reja për emërim në pozita publike, kur kompetenca për emërim i takon asaj sipas ligjit. Themelimi i komisioneve të pranimit përbën fillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtuesve të institucioneve publike dhe, si i tillë, është në kundërshtim me këtë kufizim ligjor. Përmes këtyre vendimeve, qeveria në detyrë lë dyshimin se po tenton të ndikojë në përzgjedhjen e drejtuesve të Thesarit të Kosovës, Agjencisë Qendrore të Prokurimit, Agjencisë për Siguri Kibernetike, Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, si dhe të një vargu institucioneve të tjera të rëndësishme. Këto nuk janë vende pune të zakonshme, por pozita nga të cilat administrohen financat publike, prokurimi, siguria, drejtësia dhe pasuria shtetërore”, është thënë në reagim.

Sipas IKD-së, kapja e procedurave sot mund të prodhojë kontroll institucional për vite të tëra. “Për këtë çështje tashmë ekziston një standard i qartë gjyqësor. Më 15 korrik 2025, Gjykata Supreme e ka shpallur të paligjshëm dhe e ka shfuqizuar Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Financave për pajisjet dhe sistemet fiskale. Një nga arsytet ka qenë se akti ishte nxjerrë nga një person që, pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, ushtronte njëkohësisht mandatin e deputetit dhe

funksionin e ministrit në detyrë. Gjykata ka bërë të qartë se, pas certifikimit të rezultateve, deputeti nuk mund të vazhdojë ushtrimin e kompetencave ekzekutive”, është thënë në reagimin e IKD-së.

Më tutje, IKD-ja ka vlerësuar se ky standard është i zbatueshëm edhe në rrethanat aktuale dhe qeveria nuk mund ta shpërfillojë atë. “Ligjshmëria e secilit vendim duhet të vlerësohet veçmas sipas natyrës, bazës ligjore dhe domosdoshmërisë së tij. Megjithatë, as mbështetja për një festival me rëndësi, as arsyetimi me interes publik dhe as emërtimi i një vendimi si administrativ nuk mund ta shërojnë mungesën e kompetencës së organit që vendos. Qëllimi i pretenduar si i mirë nuk e bën të ligjshëm një vendim të marrë nga persona që Kushtetuta dhe ligji i ndalojnë të ushtrojnë funksione ekzekutive. IKD-ja kërkon që qeveria të ndërpresë menjëherë çdo vendimarrje që tejkalon aktivitetet e domosdoshme dhe të planifikuara, të pezullojë zbatimin e vendimeve të 12 gushtit dhe t’i nënshtrojë ato një shqyrtimi të plotë juridik. Vendimet për komisionet e pranimit dhe çdo procedurë e re emërimi duhet të shfuqizohen pa vonesë. Kosova nuk mund të qeveriset nga njerëz që duan të jenë njëkohësisht deputetë dhe ministra, ligjvënës dhe ekzekutues të ligjit. Heshtja përballë kësaj praktike do ta kthente shkeljen në rregull dhe përjashtimin në mënyrë qeverisjeje. Kushtetuta nuk

është pengesë që pushteti mund ta anashkalojë; ajo është kufiri përtej të cilit ushtrimi i pushtetit humb legjitimitetin. Askush, as edhe një qeveri në detyrë, nuk ka mandat të veprojë jashtë këtij kufiri”, është thënë në reagimin e IKD-së.

Në anën tjetër, Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka shprehur “shqetësim serioz” për vendimet e qeverisë në detyrë në mbledhjen e mbajtur më 12 gusht. Përmes një reagimi publik, GLPS-ja i ka cilësuar vendimet të kundërligjshme, pasi shumica e anëtarëve të qeverisë në detyrë janë betuar si deputetë të Kuvendit të Kosovës. “Në rrethanat aktuale, vazhdimi i ushtrimit të kompetencave ekzekutive është i papranueshëm dhe ngre çështje serioze të ligjshmërisë së vendimmarrjes së qeverisë në detyrë”, është thënë në reagimin e GLPS-së.

GLPS-ja ka theksuar se, bazuar në Nenin 72 të Kushtetutës, Nenin 26 të Ligjit për qeverinë dhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme P.A.nr.09/2025, ndalohet ushtrimi i njëkohshëm i funksionit të deputetit dhe anëtarit të qeverisë. “Këto kufizime nuk mund të anashkalojnë përmes interpretimit politik, por janë garanci të drejtpërdrejta të parimit të ndarjes së pushteteve dhe të funksionimit të kontrollit dhe balancës ndërmjet pushteteve”, ka theksuar GLPS-ja.

Më 6 gusht 2026 GLPS-ja i është drejtuar zyrës së kryeministrit

me kërkesë për dokumentacionin që dëshmon nëse anëtarët e qeverisë në detyrë, të zgjedhur deputetë, kanë dhënë dorëheqje nga funksionet ministrore. Sipas GLPS-së, të enjten ka qenë afati i fundit ligjor për përgjigje, ndërsa organizata pret që ZKM-ja ta përmbyshë detyrimin ligjor dhe të sigurojë transparencë mbi këtë çështje. GLPS-ja ka theksuar gjithashtu se dorëheqja nga një funksion publik nuk mund të jetë vetëm një akt formal në letër, pa ndërprerjen faktike të ushtrimit të atij funksioni. “Nëse një person ka dhënë dorëheqje nga posti i anëtarit të qeverisë për të respektuar kufizimin kushtetues dhe ligjor, kjo dorëheqje duhet të prodhojë efekt real. Nuk mund të pretendohet se një funksion është ndërprerë, ndërkohë që personi vazhdon të ushtrojë kompetencat dhe përgjegjësitë që burojnë nga ai funksion”, ka deklaruar GLPS-ja.

GLPS-ja ka vlerësuar se vendimmarrja e qeverisë në detyrë është e kundërligjshme dhe nuk mund të normalizohet. Organizata u ka bërë thirrje anëtarëve të qeverisë që të jenë plotësisht transparentë dhe llogaridhënës ndaj publikut lidhur me dorëheqjet e tyre dhe statusin juridik që rrjedh prej tyre. Në fund, GLPS-ja ka kërkuar që qeveria në detyrë të përmbahet nga çdo veprim që tejkalon kompetencat e saj dhe t’i respektojë në mënyrë strikte kufizimet që burojnë nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi.

Komunat planifikojnë protestë në mbrojtje të buxheteve komunale

PRISHTINË, 13 GUSHT - Drejtori ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahim, ka bërë me dije se komunat janë duke planifikuar të protestojnë në mbrojtje të

buxheteve komunale. Ibrahim ka thënë se protesta pritet të mbahet në shtator, duke theksuar se komunat janë duke kërkuar zgjidhje për problemet financiare me të

cilat po përballen. Sipas tij, niveli qendror u ka borxh komunave rreth 360 milionë euro, ndërsa kjo situatë është duke ndikuar në funksionimin dhe realizimin e projekteve në

nivel lokal. Ai ka thënë se Asociacioni i Komunave të Kosovës do të vazhdojë të kërkojë që obligimet financiare ndaj komunave të përmbushen.



KUSARI-LILA PRET NË TAKIM DELEGACIONIN E BANGLADESHIT, SYNOHET THELLIMI I BASHKËPUNIMIT EKONOMIK

PRISHTINË, 13 GUSHT - Ministria në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Mimoza Kusari-Lila, ka pritur në takim një delegacion nga Bangladeshi, i kryesuar nga ambasadori Md. Nazrul Islam dhe S. M. Mahbulul Alam, të shoqëruar nga ambasadori i Kosovës në Bangladesh, Lulzim Pllana.

Gjatë takimit është diskutuar për thellimin e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet Kosovës dhe Bangladeshit si dhe për mundësitë konkrete për zgjerimin e bashkëpunimit në sektorë me potencial të lartë, veçanërisht në industrinë farmaceutike, bioteknologji dhe teknologjinë informative.

Një fokus i veçantë i është kushtuar krijimit të mundësive të reja për bashkëpunim biznes me biznes, përfshirë forcimin e



bashkëpunimit ndërmjet Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) dhe Dhomës së Tregtisë së Dakës (DCC).

Po ashtu, është diskutuar mundësia që kompanitë nga Bangladeshi të hapin linja prodhuese në Kosovë dhe ta

shfrytëzojnë vendin si pikë për zgjerim drejt tregjeve evropiane. Ministria Kusari-Lila ka thek-

suar se Kosova ofron një mjedis të përshtatshëm për investime falë afërsisë me tregun e Bashkimit Evropian, politikave fiskale, fuqisë punëtore konkurruese dhe mundësive për qasje në tregjet evropiane përmes CEFTA-s dhe EFTA-s.

Në takim është diskutuar edhe për nisjen e procesit për një marrëveshje dypalëshe të tregtisë së lirë ndërmjet Kosovës dhe Bangladeshit. Një marrëveshje e tillë do të mund të krijonte mundësi të reja për rritjen e shkëmbimeve tregtare, nxitjen e investimeve dhe forcimin e partneritetit ekonomik ndërmjet dy vendeve. Takimi është zhvilluar në frymën e bashkëpunimit ekonomik dhe identifikimit të hapave konkretë për t'i afruar komunitetet e biznesit të Kosovës dhe Bangladeshit.

ATK-ja RRIT KONTROLLET NDAJ BIZNESEVE, EVIDENTON RRETH 60 MILIONË EURO SHMANGIE TATIMORE

PRISHTINË, 13 GUSHT - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka rritur për 35 për qind numrin e kontrolleve ndaj bizneseve në vend, veçanërisht ndaj atyre me veprimtari sezonale.

Drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Mentor Hyseni, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 janë realizuar rreth 1 mijë e 15 kontrole, gjatë të cilave janë evidentuar rreth 60 milionë euro shmangie tatimore. Kontrollat janë përqendruar kryesisht në sektorët me rritje sezonale të qarkullimit, përfshirë pishinat, sallat e dasmave, hotelitë dhe sallonet e ondulimit. “Qëllimi është të targetohen sektorët që, potencialisht, në bazë të riskut, dalin që kanë evazion fiskal të shtuar në këtë sezon”, ka thënë Hyseni.

Ndër sektorët që ATK-ja i kon-

sideron më problematikë për shmangie tatimore janë edhe ndërtimtaria, tregtia me shumicë, hoteleria dhe disa shërbime të tjera.

Gjatë kësaj periudhe janë shqiptuar rreth 2 500 gjoba, apo rreth 8 për qind më pak se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Hyseni ka thënë se evazoni fiskal mbetet një problem i madh për Kosovën. Sipas tij, institucionet e vendit nuk kanë një vlerësim të përditësuar për nivelin e kësaj dukurie, ndërsa vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare nga periudha 2019-2020 e kanë vendosur evazionin fiskal në 25 deri në 35 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Ai ka vlerësuar se, duke marrë parasysh një PBB prej mbi 10 miliardë eurosh, edhe niveli prej 25-përqindësh do të përbënte një shumë jashtëzakonisht të



madhe. Kontrollat e ATK-së po zhvillohen edhe në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës - Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq. Sipas Hysenit, vetëm gjatë këtij

viti në këtë zonë janë regjistruar rreth 230 biznese të reja, me rreth dy milionë euro qarkullim. Një tjetër shqetësim mbetet borxhi i bizneseve ndaj ATK-së. Hyseni ka thënë se borxhi total, i akumuluar që nga përfundimi i

luftës në vitin 1999, arrin në rreth 800 milionë euro. ATK-ja synon që deri në fund të vitit të mbledhë rreth 1.2 miliard euro të hyra tatimore krahasuar me rreth 1 miliard euro të mbledhura gjatë vitit të kaluar.

Murati: Keqmenaxhimi i Termokosit nga komuna e Prishtinës po rrezikon projektin 80 milionësh

PRISHTINË, 13 GUSHT - Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, ka reaguar lidhur me paralajmërimin e KfW-së për ndërprerjen e mbështetjes për projektin e zgjerimit dhe modernizimit të ngrohjes qendrore në Prishtinë, me vlerë rreth 87 milionë euro.

Murati ka thënë se qeverisë i

është dashur të bëjë përpjekje të mëdha për ta siguruar financimin e këtij projekti, përfitues të të cilit janë banorët e Prishtinës. Sipas tij, pjesa më e madhe e financimit është grant falë mbështetjes së Qeverisë së Gjermanisë dhe Bashkimit Evropian. “Si qeveri na është dashur të bëjmë shumë mund

që të sigurojmë financimin për këtë projekt 80 milionë euro, ku përfitues janë banorët e Prishtinës. Falë mbështetjes së qeverisë gjermane dhe Bashkimit Evropian, shumica e financimit është grant”, ka deklaruar Murati. Ai e ka konsideruar të papranueshme që projekti të

vihet në rrezik për shkak të, siç ka thënë, keqmenaxhimit të ndërmarrjes Termokos nga komuna e Prishtinës. “Është e papranueshme që për shkak të keqmenaxhimit që i është bërë ndërmarrjes Termokos nga Komuna e Prishtinës, ky projekt tash të rrezikohet”, ka thënë Murati.



PROJEKTI FUTURISTIK I PARISIT PËR T'U TRANSFORMUAR NË NJË QYTET QË IU MBIJETON TEMPERATURAVE 50 GRADË

Si e ëndërrojnë arkitektët Parisin e së ardhmes... në nxehtësinë 50°C: Në pak asfalt, më shumë pemë, ujë dhe hapësira të freskëta

Parisi nuk po përgatitet më për verën aktuale, por për atë të së ardhmes. Kryeqyteti francez ka nisur një nga projektet më ambicioze të përshtatjes klimatike në Europë, duke u bazuar në një skenar që deri pak vite më parë dukej i pamundur: temperatura që mund të arrijnë deri në 50 gradë Celsius.

Ky nuk është një parashikim i sigurt, por një skenar planifikimi i bazuar në studime të institucioneve shkencore franceze, sipas të cilave temperatura të tilla nuk mund të përrjashtohen deri në fund të shekullit nëse ngrohja globale vazhdon me ritmet aktuale.

Një qytet që dikur njihej për pranverat e buta dhe verat relativisht të freskëta, sot po rishikon të gjithë mënyrën se si është ndërtuar.

Temperaturat mbi 40 gradë janë bërë gjithnjë e më të zakonshme, ndërsa shkencëtarët paralajmërojnë se klima e Parisit në dekadat e ardhshme mund të ngjasojë me atë të Andaluzisë.

Pasiguria klimatike mori një dimension të ri pas verës së vitit 2003, kur një valë ekstreme e të

nxehtit shkaktoi rreth 15 mijë viktima në Francë, mbi një mijë prej tyre vetëm në zonën e Parisit. Më pas, episode të tjera ekstreme bindën autoritetet se temperaturat e larta nuk janë më një emergjencë e përkohshme, por një problem afatgjatë urban. Strategjia e Parisit bazohet në një parim të thjeshtë: jo të ftohet qyteti me mijëra kondicionerë, por të parandalohet mbinxehja e tij. Objektivi kryesor është reduktimi i asfaltit dhe betonit, materialet që thithin nxehtësinë gjatë ditës dhe e çlirojnë atë gjatë natës.

Një nga projektet simbol është transformimi i oborreve të shkollave, të njohura si "Cours Oasis". Hapësirat e mëparshme të mbuluara me beton po kthehen në mini-parqe urbane me pemë, kopshte, zona me hije, sipërfaqe që thithin ujin dhe hapësira për lojëra.

Studimet kanë treguar se këto ndërhyrje përmirësojnë ndjeshëm temperaturën lokale dhe krijojnë ambiente më të jetueshme për fëmijët. Por plani nuk kufizohet vetëm te shkollat. Parisi ka krijuar një rrjet me mbi 1400 "ishuj freskie", që përfshijnë parqe, kopshte, biblioteka, muze, pishina dhe ndërtesa publike ku qytetarët mund të strehohen gjatë valëve të të nxehtit.

Qyteti po mbjell mijëra pemë të



reja, po shndërron sheshe dhe rrugë në zona të gjelbra dhe po zëvendëson gradualisht sipërfaqet e padepërtueshme me materiale që lejojnë depërtimin e ujit.

Edhe ndërtesat publike po ndryshojnë, me çati të ljera me ngjyrë të gjelbër, mbulesa reflektuese dhe fasada me bimësi për të ulur temperaturat pa rritur përdorimin e energjisë. Edhe Sena është pjesë e kësaj strategjie. Pas dekadash pastrimi të ujërave, lumi po rikthehet si hapësirë publike ku njerëzit

mund të freskohen gjatë ditëve të nxehta, duke u bërë pjesë e një sistemi më të gjerë klimatik urban.

Megjithatë, sfida më e madhe mbeten periferitë e Parisit, ku miliona banorë jetojnë në zona me pak pemë, shumë beton dhe ndërtesa të ndërtuara në një kohë kur problemi kryesor ishte ruajtja e nxehtësisë në dimër, jo mbrojtja nga vapës ekstreme. Ekspertët paralajmërojnë se edhe masat më të avancuara nuk mund ta eliminojnë plotësisht rrezikun. Vala e të nxehtit ekstrem

të këtij viti, po tregon se përshtatja duhet të përshejtohet, por gjithashtu se pa këto ndërhyrje pasojat mund të ishin edhe më të rënda.

Mësimi i Parisit është se qytetet e së ardhmes nuk do të mbrohen nga një projekt i vetëm gjigant, por nga mijëra ndryshime të vogla: një pemë më shumë, një rrugë pa asfalt, një park i ri, një çati e gjelbër apo një burim uji. Përballë një klime që po ndryshon me shpejtësi, Parisi po përpiqet të ndërtojë një qytet jo për temperaturat e së kaluarës,

GROENLANDA DETYRON KOMPANINË AMERIKANE TË LIDHUR ME TRUMPIN TË SHTYJË SHPIMET PËR NAFTË

Autoritetet e Groenlandës kanë detyruar një kompani amerikane të naftës, e lidhur me administratën e Donald Trumpit, të shtyjë planet për shpimin e puseve në territorin arktik.

Vendimi vjen në një kohë tensionesh të shtuara rreth Groenlandës, pasi kompania kishte sjellë në korrik pajisje shpimi në bregun lindor të territorit pa marrë lejet përkatëse. Autoritetet groenlandeze i kishin dhënë kompanisë një paralajmërim të fortë për këtë veprim.

Vetëm një javë para datës së planifikuar për nisjen e shpimeve, qeveria e Groenlandës njoftoi se procesi i nevojshëm rregullator nuk mund të përfundonte në kohë dhe se lejet përkatëse nuk mund të merreshin përpara fillimit të planifikuar të punimeve.

Autoritetet kanë shprehur shqetësimet lidhur me afatin e ngushtë për vlerësimin e ndikimit të projektit në mjedis dhe në komunitetet lokale. Tashmë duhet të vendoset nëse do të lejohet shpimi në një zonë



ligatinore të mbrojtur, e cila është habitat për specie të rralla shpendësh dhe për kafshët muskoks, të rëndësishme për gjuetarët vendas.

Sipas qeverisë së Groenlandës dhe kompanisë, në skenarin më të hershëm, shpimet mund të nisin në dimrin e vitit 2027.

Ky afat është dukshëm më i gjatë

se parashikimi i bërë në maj nga Jeff Landry, guvernatori republikan i Luizianës dhe i dërguari i Trumpit për Groenlandën. Pas një vizite në territor, Landry kishte deklaruar se nafta e supozuar nën tokën e Groenlandës mund të hynte në prodhim brenda rreth 10 muajsh.

Kompania Greenland Energy, e

cila synon të zhvillojë kërkimet në rajonin e largët të Jameson Land, pretendon se aty mund të ndodhet naftë me vlerë deri në 1 trilion dollarë.

Drejtori ekzekutiv i kompanisë, Robert Price, tha se Greenland Energy mbetet e përkushtuar ndaj programit të kërkimit të naftës dhe se do të shfrytëzojë kohën shtesë për të përmirësuar planet dhe për të forcuar marrëdhëniet me komunitetet lokale dhe autoritetet.


Kompania, e krijuar vitin e kaluar, ka planifikuar të investojë 60 milionë dollarë të mbledhura nga investitorët për shpimet, në këmbim të një pjese kontrolluese në projekt. Partneri britanik 80 Mile ka konfirmuar se shtyrja lidhet me nevojën për përfundimin e procedurave të lejeve dhe miratimeve rregullatore.

Megjithëse përfaqësuesit e Greenland Energy kanë mohuar se projekti ka lidhje me planet amerikane për aneksimin e Groenlandës, kompania ka disa lidhje me persona pranë administratës Trump.

Prezantuesi televiziv Phil McGraw, i njohur si Dr. Phil, ka një marrëveshje me kompaninë për një seri dokumentarësh mbi projektin. Në bordin e Greenland Energy ndodhet gjithashtu një veteran i marinës amerikane i përfshirë në projektin e mbrojtjes raketore "Golden Dome", ndërsa miliarderi Kenneth Griffin, një donator i rëndësishëm i Trumpit, zotëron rreth 9 për qind të aksioneve të kompanisë.

Shtyrja e shpimeve pati ndikim të menjëhershëm edhe në treg. Aksionet e Greenland Energy ranë me më shumë se një të tretën pas njoftimit për vonesën, duke zbehur pritshmëritë e investitorëve për një rritje të mundshme të vlerës së kompanisë të nxitur nga mbështetja politike e Trumpit.

Groenlanda ka ndaluar dhënien e licencave të reja për kërkime naftë që nga viti 2021, duke e lidhur vendimin me krizën klimatike. Megjithatë, 80 Mile vazhdon të mbajë licenca eksplorimi të dhëna përpara këtij vendimi.



Superliga e Kosovës në futboll nis sot me ndeshjen në Drenas

PRISHTINË, 13 GUSHT - Sezoni 2026/27 në Superligën e Kosovës në futboll do të nisë sot (e premte). Tashmë është përcaktuar edhe ndeshja hapëse e tij. Feronikeli '74 - Gjilani është

ndeshja që do ta hapë xhiron e parë të sezonit të ri në elitën e futbollit të Kosovës. Kjo përballje luhet sot, ndërsa katër duelet e tjera të xhiros së parë do të zhvillohen të shtunën dhe të dielën.

Ndeshja Feronikeli '74 - Gjilani do të zhvillohet në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas nga ora 16:30. Skuadra nga Drenasi është rikthyer këtë sezon në Superligë dhe drejtohet nga trajneri Elon

Berisha, kurse Gjilani që udhëhiqet nga Debatik Curri synon të nisë me rezultat pozitiv. Përballjet e tjera të xhiros së parë janë: Drenica - Dukagjini, Vushtrria - Malisheva, Drita - Llapi dhe Prishtina - Ballkani.



ADEMI: SUPERLIGA E RE SJELL NJË RISI TË MADHE, KLUBET DO TA KENË EDHE FUTBOLLIN E FEMRAVE

PRISHTINË, 13 GUSHT - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka folur për përgatitjet për fillimin e edicionit të ri të Superligës së Kosovës, 2026/27, duke theksuar se FFK-ja është e gatshme në aspektin organizativ. Në një intervistë për "RTK Radio", Ademi ka deklaruar se janë përditësuar rregulloret e garave, ndërsa po zhvillohen seminare me delegatët dhe gjyqtarët para nisjes së kampionatit. "FFK-ja nga pjesa e vet që e bën për



organizimin e garave të futbollit, sidomos të Superligës që fillon tash dhe të

Ligës së Parë, pra garat zyrtare të këtyre ligave, jemi të gatshëm në të gjitha aspektet.

Ka mbetur vetëm pjesa e delegatëve, që është duke u mbajtur një seminar me ta për të parë se çfarë ka ndryshime dhe risi", ka deklaruar Ademi. Ai ka shtuar se janë përditësuar të gjitha rregulloret e garave, me qëllim që të qartësohen edhe situatat që në të kaluarën nuk kanë qenë të definuara në mënyrë të plotë. "Këto rregullore gjithmonë do të jenë në të mirë të futbollit. Edhe me referë janë duke u mbajtur seminare", ka thënë presidenti i FFK-së. I pyetur se çfarë do ta veçojë

edicionin 2026/27 nga kampionatet e kaluara, Ademi ka veçuar një ndryshim të rëndësishëm në organizimin e klubeve. "Secili kampionat ka të veçantat e veta. Këtë si ligë do ta veçojë ajo se ekipet e Superligës do të kenë edhe futbollin e femrave. Të gjitha klubet janë duke punuar në këtë drejtim për t'i formuar ekipet e veta", është shprehur Ademi. Edicioni i ri i Superligës së Kosovës nis më 15 gusht 2026, ndërsa pritet të sjellë edhe risi të tjera në organizimin dhe zhvillimin e futbollit vendor.

DIFERENCA FINANCIARE ENORME, KLUBET E PROMOVUARA NË PREMIERLIGË SHPENZOJNË MË SHUMË SE PJESA TJETËR E EVROPËS

LONDËR, 13 GUSHT - Diferenca financiare mes Premierligës dhe katër ligave të tjera elitare të Evropës është e jashtëzakonshme. Sipas shifrave deri më 12 gusht, klubet e promovuara në Premierligë kanë shpenzuar plot 290.6 milionë funte në merkaton e kësaj vere. Ipswich Town kryeson me rreth 143.6 milionë funte të shpenzuara, i ndjekur nga Coventry me 93.8 milionë dhe Hull City me 53.8 milionë funte. Në Serinë A, klubet e promovuara kanë shpenzuar gjithsej 51.2 milionë funte. Venezia ka investuar 38.1 milionë, Monza 7.8 milionë dhe Frosinone 5.3 milionë funte. Në La Liga, klubet e promovuara kanë shpenzuar 30.3 milionë funte. Deportivo



ka shpenzuar 22.6 milionë, Racing Santander 7.4 milionë, ndërsa Málaga vetëm 300 mijë funte. Në Bundesliga shpenzimet arrijnë në 13.1 milionë funte. Elversberg ka investuar 9 milionë, Schalke 2.3 milionë dhe Paderborn 1.8 milion funte. Ndërsa në Ligën 1, klubet e promovuara kanë shpenzuar vetëm 1.5 milion funte, të gjitha nga Troyes, ndërsa Le Mans

nuk ka shpenzuar asnjë cent. Në total, klubet e promovuara nga Seria A, La Liga, Bundesliga dhe Liga 1 kanë shpenzuar rreth 96.1 milionë funte. Kjo do të thotë se vetëm klubet e promovuara në Premierë Ligë kanë shpenzuar rreth 194.5 milionë funte më shumë se klubet e promovuara nga katër ligat e tjera së bashku. Pra, klubet e sapopromovuara në Premierë Ligë kanë shpenzuar pothuajse tri herë më shumë se klubet e promovuara nga katër ligat e tjera të mëdha evropiane të kombinuara. Shifrat tregojnë edhe një herë fuqinë financiare të Premierë Ligës dhe hendekun e madh ekonomik që ekziston mes futbollit anglez dhe pjesës tjetër të elitës evropiane.

PSG-ja TRIUMFON NDAJ ASTON VILLAS DHE FITON SUPERKUPËN E EVROPËS

SALZBURG, 13 GUSHT - Paris Saint-Germain (PSG) ka fituar Superkupën e Evropës pas triumfit ndaj Aston Villas. "Parisienët" kanë dëshmuar se kanë synime të mëdha edhe në sezonin e ardhshëm pas një paraqitjeje të shkëlqyer ndaj Villas pavarësisht se epilogu rezultoi të jetë 2-1. Khvicha Kvaratskhelia e ka kaluar PSG-në në epërsi pas një asistimi fantastik të Desire Doue (20'). Aston Villa pas kësaj ka pasur disa mundësi shënimi, megjithatë Brian Madjo ka dështuar disa herë nga afërsia. Sidoqoftë, ai i ka përmirësuar gabimet dhe ka realizuar me kokë pas harkimit të John McGinn (45'). Villa e ka nisur më mirë edhe pjesën e dytë, ku McGinn ka qenë afër të shënojë një supergol, por



portieri me një superpritje ia ka mohuar golin. Heroi i PSG-së ka rezultuar të jetë Doue, që ka shënuar një gol nga afërsia pas një kundërsulmi. Fillimisht goli është anuluar për pozitë jashtë loje, por më pas VAR-i e ka korrigjuar vendimin (62'). Kësisoj, PSG-ja e ka nisur me trofe sezonin, ndërsa Luis Enrique e ka bërë të qartë se synimi është të bëhen ekipi i dytë pas Real Madridit që e fiton tri herë radhazi Ligën e Kampionëve.

Xavi Hernandez emërohet trajner i ri i Holandës

AMSTERDAM, 13 GUSHT - Xavi Hernandez është emëruar trajner i ri i kombëtares së Holandës. Trajneri 46-vjeçar spanjoll do ta marrë drejtimin e "Tulipanëve", duke

zëvendësuar Ronald Koemanin. Xavi ka arritur marrëveshje me Federatën Holandeze të Futbollit (KNVB) për një kontratë që do ta mbajë në krye të kombëtares deri në

përfundim të Botërorit 2030. Ish-mesfushori i Barcelonës nis kështu një aventurë të re në nivelin e kombëtareve, pas përvojës si trajner në futbollin e klubeve. Objektivi kryesor i

Xavit do të jetë ndërtimi i një skuadre konkurruese të Holandës dhe përgatitja e saj për sfidat e mëdha ndërkombëtare të viteve të ardhshme.





SHPALLJE E VENDIT TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Zyrtar/e për Analiza
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti:	Menaxhimi i Mjeteve dhe Rezervave
Divizioni:	Letra me Vlerë
Grada:	P06
Raporton:	Udhëheqësit të Divizionit për Letra me Vlerë

Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësi:

- Kontribuon në organizimin dhe realizimin e ankandeve të letrave me vlerë të Qeverisë, në koordinim me institucionet pjesëmarrëse në treg.
- Mbështet administrimin e sistemeve dhe platformave elektronike që përdoren për procesin e ankandit dhe regjistrimin e operacioneve me letra me vlerë.
- Përgatit raporte periodike dhe ad-hoc mbi zhvillimet në tregun e letrave me vlerë, strukturën e borxhit publik dhe trendet e tregut financiar.
- Mbledh, përpunon dhe analizon të dhëna nga burime të brendshme dhe të jashtme për qëllime vlerësimi dhe raportimi.
- Monitoron dhe analizon transaksionet në tregun primar dhe sekondar të letrave me vlerë të realizuara nga pjesëmarrësit në sistem.
- Kontribuon në hartimin dhe përditësimin e procedurave operative dhe udhëzimeve të brendshme që rregullojnë funksionimin e tregut të letrave me vlerë të Qeverisë.
- Ofron mbështetje analitike në vlerësimin e instrumenteve financiare, përfshirë bonot e thesarit dhe obligacionet qeveritare.
- Identifikon dhe analizon rreziqet e tregut, përfshirë rrezikun ligjor, operacional dhe sistematik.
- Ofron mbështetje për institucionet financiare pjesëmarrëse (veçanërisht bankat) lidhur me pjesëmarrjen e tyre në treg përmes sistemit përkatës.
- Ndjek zhvillimet në tregjet financiare vendore dhe ndërkombëtare dhe propozon praktika të mira për aplikim në Kosovë.
- Siguron integritetin, saktësinë dhe përditësimin e bazës së të dhënave të divizionit.
- Kryen analiza mujore dhe vjetore mbi volumet e transaksioneve dhe strukturën e pjesëmarrësve në sistem.
- Përgatit raporte statistikore dhe analitike për nevoja të publikimit.
- Siguron respektimin e kornizës ligjore dhe rregullative në fuqi gjatë ushtrimit të detyrave.
- Asiston mbikëqyrësin në komunikim dhe takime me palë të brendshme dhe të jashtme.
- Kryen detyra të tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit, në përputhje me natyrën e pozitës.

Përgatitjet Profesionale/Kualifikimet:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, shkencave kompjuterike, teknike, matematikës apo fushat tjera të cilat ndërlidhen me fushën e njësisë organizative, sipas përshkrimit të publikuar në këtë shpallje si dhe uebfaqen e BQK-së në linkun: [Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve dhe Rezervave - BQK](#) ;
- Të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në sektorin financiar, ose përvojë në fushën që ndërlidhet me përgjegjësitë e njësisë organizative sipas përshkrimit të publikuar në këtë shpallje si dhe uebfaqen e BQK-së në linkun: [Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve dhe Rezervave - BQK](#);
- Preferohen certifikime nga fusha e tregut financiar dhe/apo të letrave me vlerë;
- Demonstrim i aftësive të shquara të komunikimit verbal dhe me shkrim, dhe prezantimit tek mbikëqyrësi dhe palët tjera;
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive me mbikëqyrësin dhe ekipin;
- Aftësi të caktimit të prioriteteve të punës dhe të përmbushjes së afateve;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Kërkesat e posaçme:

- Aftësi komunikuese në të shkruar si dhe aftësi për kryerjen e detyrave sipas prioriteteve;
- Shkathhtësi organizative, planifikimit dhe të menaxhimit të kohës;
- Vëmendje në detaje, në formulime të qarta dhe saktësi;
- Vetëiniciativë dhe gatishmëri për punë ekipore;
- Njohuri të shkëlqyera në përdorimin e sistemeve kompjuterike, MS Office dhe të ngjashme;
- Person me etikë të lartë dhe i/e aftë në ruajtjen e konfidencialitetit.
- Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:
- Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të **Formularit zyrtar të BQK-së gjatë aplikimit online** nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes.
- Kandidatët duhet të **bashkëngjisin letër përcjellëse (motivuese)**, e cila duhet të jetë e adresuar dhe e përgatitur **posaçërisht për pozitën për të cilën aplikojnë**; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim;
- Dëshmi mbi përvojën e punës, që mbulojnë paku dy (2) vite përvojë pune** (kopje të kontratave të punës, vërtetime nga punëdhënësi apo dokumente të tjera relevante që dëshmojnë pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti) për periudhën përkatëse**, që mbulon **së paku dy (2) vite përvojë pune**, ose, në rastet kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht, vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet
- të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **31 gusht 2026**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naslov radnog mesta:	Službenik/ca za Analize
Trajanje zaposlenja:	na neodređeno vreme
Departman:	Upravljanje Sredstvima i Rezervama
Odsek:	Hartije od vrednosti
Stepen:	P06
Izveštava:	Rukovodiocu Odseka za Hartije od Vrednosti

Opis dužnosti i odgovornosti:

- Doprinosi organizovanju i realizovanju aukcija hartija od vrednosti Vlade, u koordinaciji sa institucijama koje učestvuju na tržištu.
- Podržava administriranje elektronskih sistema i platformi koje se koriste za proces aukcije i registraciju operacija sa hartijama od vrednosti.
- Priprema periodične i ad-hok izveštaje o dešavanjima na tržištu hartija od vrednosti, strukturi javnog duga i trendovima na finansijskom tržištu.
- Prikuplja, obrađuje i analizira podatke iz internih i eksternih izvora u svrhu evaluacije i izveštavanja.
- Prati i analizira transakcije na primarnom i sekundarnom tržištu hartija od vrednosti koje sprovode učesnici u sistemu.
- Doprinosi izradi i ažuriranju operativnih procedura i internih uputstava koja regulišu funkcionisanje tržišta hartija od vrednosti Vlade.
- Pruža analitičku podršku u evaluaciji finansijskih instrumenata, uključujući blagajničke (trezorske) zapise i vladine obveznice.
- Identifikuje i analizira tržišne rizike, uključujući pravni, operativni i sistemski rizik.
- Pruža podršku finansijskim institucijama učesnicama (posebno bankama) u vezi sa njihovim učešćem na tržištu putem relevantnog sistema.
- Prati dešavanja na domaći i međunarodnim finansijskim tržištima i predlaže dobre prakse za primenu na Kosovo.
- Obezbeđuje integritet, tačnost i ažuriranje baze podataka odseka.
- Vrši mesečne i godišnje analize o obimu transakcija i strukturi učesnika u sistemu.
- Priprema statističke i analitičke izveštaje za potrebe objavljivanja.
- Obezbeđuje usklađenost sa važećim zakonskim i regulatornim okvirom tokom obavljanja dužnosti.
- Pomaže nadzorniku (supervizoru) u komunikaciji i sastancima sa internim i eksternim stranama.
- Obavlja i druge poslove na zahtev nadzornikaa, u skladu sa prirodom pozicije.

Stručna sprema/kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma iz ekonomije, računarskih nauka, tehničkih nauka, matematike ili drugih oblasti povezanih sa oblašću organizacione jedinice, prema opisu objavljenom u ovom oglasu i na veb stranici CBK-a na linku: [Departman za Upravljanje Sredstvima i Rezervama - CBK](#);
- Da aima najmanje dve (2) godine stručnog radnog iskustva u finansijskom sektoru ili iskustvo u oblasti koja se odnosi na odgovornosti organizacione jedinice prema opisu objavljenom u ovom oglasu i na veb stranici CBK na linku: [Departman za Upravljanje Sredstvima i Rezervama - CBK](#);
- Poželjne su sertifikacije iz oblasti finansijskih tržišta i/ili hartija od vrednosti;
- Demonstriranje odličnih usmenih i pismenih komunikacijskih veština, kao i veština prezentacije pred nadzornika i drugim stranama;
- Sposobnost da efektivno radi sa nadzornikom i timovima;
- Sposobnost određivanja prioriteta u radu i poštovanja rokova;
- Tečno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika, usmeno i pismeno;
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.

Specifični zahtevi:

- Veštine pisane komunikacije kao i sposobnost obavljanja zadataka prema prioritetima;
- Organizacione i veštine, veštine za planiranje i upravljanje vremenom;
- Pažnja posvećena detaljima u jasnim formulacijama i tačnosti;
- Samoinicijativa i spremnost za timski rad;
- Odlično poznavanje korišćenja računarskih sistema, MS Office-a i slično;
- Lice sa visokom etikom i spreman/a u očuvanju poverljivosti.
- Svi kandidati moraju da dostave sledeća dokumenta:**
- Prijave sa nepotpuno i netačno popunjenim **zvaničnim Obrascem CBK-a tokom prijavljivanja online** neće biti razmatrane i rezultiraće diskvalifikacijom tokom procesa selekcije.
- Kandidati moraju **priložiti motivaciono pismo**, koje mora biti adresirano (upućeno) i pripremljeno **posebno za poziciju za koju se prijavljuju**; u suprotnom, prijava neće biti razmatrana;
- Dokaz o radnom iskustvu, koji pokriva najmanje dve (2) godine radnog iskustva** (kopije ugovora ili potvrda od poslodavca ili drugih relevantnih dokumenata koji služe za dokazivanje zauzete pozicije i radnog iskustva, bez obzira na relevantne zakone za zaštitu ličnih podataka).
- Izveštaj iz Kosovskog penzionog fonda (Trusta) za relevantni period**, koji pokriva **najmanje dve (2) godine radnog iskustva**, ili poreska potvrda iz Poreske Administracije (PAK) kada izveštaj iz Trust-a nije pravno primenljiv);
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.
- Procedura za prijavljivanje:**
- Krajnji rok za prijavljivanje je **31 avgust 2026**.
- Prijava se može podneti onlajn (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a. Drugi oblici (načini) prijavljivanja neće se uzeti u obzir.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Power Your German” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812360767 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Power Your German” D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812360767 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Power Your German” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812360767 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Hak Bau” SH.P.K. nga Gjakova bënë rritjen e kapitalit të SH.P.K me numër Unik Identifikues 812452382 të lëshuar nga ARBK.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m. “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbresa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L